



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 17/2009
Më 26. 05. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj, Mufëra Şinik dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Safete Hadërgjonaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Berisha – ZPRK, Blerina Uka – NDI, dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19. 05. 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të ART-së, për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 19. 05. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 19. 05. 2009 u miratua me vërejtjet e deputetes Sala Berisha - Shala.

III. Shqyrtimi i Raportit të ART-së për vitin 2008

Zef Morina – Theksoi se nuk heq dorë nga propozimi i tij, i paraqitur edhe në mbledhjet e kaluara. Ky raport duhet t'i kthehet ART-së, për arsye shumë të qartë. Nëse ata marrin paga prej buxhetit dhe nuk vijnë të raportojnë në Komision, nuk ka çka të debatohet më tepër. Prandaj propozoi që një shkresë t'i dërgohet Kryesisë, sepse Raporti nuk është diskutuar dhe duhet të kthehet prapa.

Ethem Çeku – Tha se në mbledhjen e fundit është marrë vendim që sot Raporti të diskutohet me ose pa praninë e ART-së, sepse të gjitha vërejtjet po vihen mbi Komisionin si në opinion, ashtu edhe media. Kërkoj të debatohet, nëse ka çka të debatohet. Nëse nuk ka, t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit dhe Kryesia të marrë qëndrim.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se Komisionit i takon të japë mendim dhe ta përcjellë në procedim këtë raport në séancë plenare, sepse atyre që janë përgjegjës u është dhënë mundësi më e madhe se sa është dashur, të vijnë dhe të raportojnë. Shtoi se në pamundësi që sipas rregullave të punës të Komisionit, por edhe detyrimet që dalin për agjencinë përkatëse para Komisionit dhe Kuvendit, duhet të procedohet më tutje. Në vlerësimin për Raportin tha se i ka mangësitë e veta, por Komisionit i takon ta japë një mendim lidhur me këtë, në mënyrë që të procedohet me defektet që ka Raporti. Në Kuvend t'i jepet përgjigje meritorë agjencisë, pastaj t'i presim rekomandimet që nxjerrë Kuvendi, pavarësisht edhe pse i ka kaluar mandati. Qëndron fakti se agjencitë kanë pasur për detyrë të raportojnë. Konsideroj se nuk e kanë kryer punën si duhet, krejtësisht e kanë injoruar punën e Komisionit, në veçanti dhe Kuvendin në përgjithësi. Në fund tha se ky ishte mendimi i tij personal se nuk e kanë kryer detyrën në pajtim me mandatin, për të cilin u është dhënë vota.

Sala Berisha – Shala – Pajtohet që ky raport të procedohet më tej. Kryesia le të vendosë. Ishte e pajtimit që vlerësimet t'i jepnin grupet parlamentare.

Kaqusha Jashari – Ishte e pajtimit me deputetët e tjerë që ky raport të procedohet në Kryesi.

Kryetarja – E përkrahu propozimin e z. Rexhepi, që Raporti të procedohet në Kryesi, sepse atje marrin pjesë edhe shefat e grupeve parlamentare, që janë anëtarë të Kryesisë të partive politike dhe për këtë çështje të vendoset në Kryesi.

Pas debatit Komisioni me 7 (shtatë) vota për dhe 1(një) kundër, nxori këtë

Përfundim

I. Komisioni e shqyrtoi Raportin e ART-së, për vitin 2008. Me gjithë konstatimin e shumë mangësive e të paqartësive, si dhe në mungesë të përsëritjes së pjesëmarrjes së përfaqësuesit të Bordit të ART-së nxori këtë

Rekomandim

I. Kryesia e Kuvendit ta procedojë në seancë plenare, për shqyrtim Raportin e ART-së, për vitin 2008.

IV. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët

Berim Ramosaj – Theksoi se Raporti për rrugët është një përshkrim më shumë i të drejtave dhe i detyrave të Komisionit, pra të më shumë fushave, ose vetëm nga ana juridike. Edhe rekomandimet janë krejt të përgjithësuara dhe nuk kanë asgjë kreative. Shtoi se përshtypjet e tij ishin se disa shenja të trafikut, nëse nuk zbatohen vërtet do të jenë shkelje të ligjeve. Shtoi se aty është dashur të futen prioritetet e rrugëve, që i financon Ministria, që të dihet se a është kriteri i popullsisë, kriteri i zhvillimit ekonomik, apo kriteri që është në parti politike të ministrit? Në fund tha se duhet të saktësohet dhe të futet çështja e prioriteteve të shtrimit të rrugëve në rekomandimin e Projektit të zbatimit të Ligjit për rrugët, sepse tek e fundit ligji parasheh një gjë të tillë.

Kaqusha Jashari –Tha se në Raport është mirë të futet çdo segment i Ligjit, që duhet ta ketë vlerësimin e vet, d.m.th. prej fillimit deri në fund, e jo vetëm disa çështje që janë evidente. Mungon regjistri i kategorizimit të rrugëve dhe për shkak të mungesës së tyre në Kuvendet Komunale, del se edhe në nivelin e Kosovës mungon ai regjistër. Ekzistojnë regjistra të saktë, data Base në Drejtorinë e Rrugëve, por nuk është bërë rikategorizimi si është thënë me Rregullore. Kjo rregullore është miratuar pas plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit. Për mirëmbajtjen e rrugëve është futur Plani vjetor etj.

Zef Morina – Theksoi se grupi i punës e nxori një përmbledhje mbi bazën e atyre që janë vërejtur, qoftë në takime, qoftë edhe nëpër Komuna. Janë rekomandimet që i nxjerr Komisioni në Raport. Janë 7 (shtatë) udhëzime administrative, që janë bazë e funksionimit ose e zbatimit të Ligjit nga Ministria dhe kuvendet komunale. Ato që i theksoi znj. Jashari, janë përfshirë. Në një mënyrë janë përfshirë të gjitha vërejtjet, me përjashtim të asaj që tha z. Ramosaj, sepse me ligj Ministria e përgatit planin vjetor për mirëmbajtjen, për ndërtimin dhe strukturimin e rrugëve. Këtë plan e paraqet në Qeveri, ku edhe miratohet, ndërkaq nuk kemi mundësi t’ia diktojmë rrugën që merr Komisioni për asfaltimin. Mirëpo, Ministria, sipas ligjit e ka për detyrë t’i ndërtojë rrugët rajonale, magjistrale dhe tash autoudhën. Rrugët lokale nuk ka për detyrë t’i ndërtojë, por nëse e sheh të arsyeshme, në bashkëpunim me donatorët, qofshin ata banorë ose donatorë të tjerë, mund të ndërtojë. Udhëzimet administrative ekzistojnë edhe në bazë të tyre

funksionohet, mirëpo Komisioni duhet t'ia rekomandojë Kuvendit, në atë mënyrë që Kuvendi t'ia rekomandojë Qeverisë, udhëzimet administrative për vendosjen e shenjave në trafik. Udhëzimi administrativ për caktimin e kriterëve teknike për ndërtimin dhe ristrukturimin e rrugëve, Udhëzime administrative për kordinimin e programeve për rrugët publike, që duhet t'i nxjerrë Ministria. Udhëzime administrative për ndikimin në mjedis - në bashkëpunimin me ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Udhëzim administrativ për regjistrin e rrugëve, Udhëzim administrativ si duhet ta detyrojë, qoftë Drejtoria e Rrugëve, qoftë Departamenti i Rrugëve, duhet të hartohen data Basat. Në fund të diskutimit i kritikoi kuvendet komunale, përveç të Prishtinës dhe të Mitrovicës, që fare nuk kanë dhe as nuk dinë çka është kategorizimi i rrugëve në asnjë komunë, dhe nuk kanë plan vjetor për mirëmbajtjen e rrugëve, as plan se cilat rrugë janë me përparësi, por nuk dinë cila rrugë duhet të kategorizohet.

Fatmir Rexhepi – Tha se është e vërtetë që kontrolli i punës, d.m.th. i ministrisë përkatëse bëhet nga Komisioni parlamentar. Njëra prej tyre është edhe kjo formë që e sheh mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit dhe i bën konstatimet, vlerësimet dhe rekomandimet, pastaj raportohet në Kuvend. Duke diskutuar hollësisht Raportin për monitorimin e Ligjit theksoi nën 1 (një) se janë dhënë 13 (trembëdhjetë) detyrime që duhet të realizohen nga ekzekutivi dhe në nivel lokal. Po të lexohen dhe të përkthehen konstatimet që i nxjerr Komisioni: I kemi 3(tri) konstatime shumë interesante, pra problemet i identifikojmë, me një fjalë mungon vlerësimi i tërësishëm i kësaj që thuhet. Së dyti është plani vjetor, në të cilin është identifikuar si problem, mungesa e planit vjetor. Konkluzioni ka arritur në problemin e zbatimit të këtij ligji - ku janë: projektimi, ndërtimi, ristrukturimi, rregullat e veçanta, mirëmbajtja e shenjave, zbatimi i kriterëve teknike etj. Kjo paraqet pikëpyetje të madhe. Shtoi se dilema më e madhe është kjo: sa është shkalla e zbatimit të këtij ligji? Nëse qëndrojnë këto vërejtje kaq të mëdha që argumentohen me 6 (gjashtë) rekomandimet e Raportit, vijmë në përfundim se po punohet pa ligj.

Zef Morina – Kërkoj që debati të zhvillohet në nivel profesional, sepse Udhëzimet administrative, që janë kërkuar për t'u bërë, nuk do të thotë se është punuar pa kriterë. Mirëpo duhet të jetë një udhëzim administrativ, që në një farë mënyre e fuqizon përdorimin e atyre kriterëve. Kërkohet kohë të nxirren udhëzimet administrative, sepse Ministria nuk ka mundur të gjitha udhëzimet t'i nxjerrë për një vit. mirëpo brenda këtij mandati rekomandojmë të nxirren ato.

Fatmir Rexhepi – Tha se duke u bazuar në propozim rekomandimet që janë paraqitur në Raport të jepet e të kuptohet se ekziston një dilemë e madhe: sa zbatohet Ligji në ndërtimin e rrugëve, sepse një rekomandim thotë: se duhet të nxirret rekomandim për përcaktimin e kriterëve teknike të ndërtimit dhe të ristrukturimit të rrugëve. Shtoi se pajtohet më katër konstatimet, mirëpo kërkoj të nxirret një përfundim korrekt.

Sala Berisha – Shala – E falënderoi NDI- në për kontributin e dhënë në monitorimin e Ligjit për Rrugët, mirëpo tha që të mos keqkuptohej kërkoj shpjegim, si është përfshirë në Grupin e punës, kur nuk ka qenë në përbërjen e këtij grupi, përveç kur ka marrë pjesë në takime si Komision. Po ashtu ishte e mendimit se pas largimit të kryetarit të Grupit të

Punues është dashur të hiqet tërësisht Grupi i Punës. Gjatë diskutimit të hollësishëm të Raportit pyeti, se gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit, a është vërejtur sa është respektuar Ligji, sa është zbatuar ligji në terren gjatë kësaj kohe, se a janë përfshirë mangësitë e plotësimit dhe të ndryshimit të tij. Tha se këtu përmenden edhe shumë rekomandime, për të cilat në kohën e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit, të përfshihen dhe theksoi se secili duhet ta shohë kontributin e vet. Atëherë kishte mundësi këto ndryshime të futeshin në Ligj. Po ashtu kërkoi këshillë ligjore, se sipas rekomandimit për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, a ka të drejtë të propozojë Komisioni apo deputetët, apo duhen të rregullohen ato çështje për fusha të caktuara në kuadër të ligjit. Shtoi se në shumicën e ligjeve, kur nuk ka mundësi të zërthehet më tutje kjo çështje të rregullohet me udhëzim administrativ. Duhet të shikohet se këto rekomandime, që janë propozuar, a janë kompatible me ligjin në fuqi, që tani është me ndryshime dhe plotësime etj. Duke u bazuar në ato që u thanë më lart, nuk kemi mundësi të vërejmë saktësisht sa është zbatuar ky ligj, faktikisht ç'rëndësi ka monitorimi i zbatimit të ligjeve. Ka edhe efektin e zbatimit, cilat janë vështirësitë, nëse nuk zbatohet, ku janë defektet, a janë defektet se nuk ka punuar ministria, apo defekti është se ligji ka qenë i pazbatueshëm në terren. Në fund tha se është e zhgënjyer, pas disa takimeve që ka pasur gjatë monitorimit, sidomos nëpër komuna, në të cilat nuk kanë ditur se ka ligj. Krejt debatin e kanë shtruar për çështje periferike, por jo edhe për çështje përmbytësore që rregullohen me ligj. Mirëpo ajo tha se Projektraportit do t'i bëhen disa plotësime dhe ndryshime. Propozoi të ftohen përfaqësuesit e ministrisë që të jepen të gjitha përgjigjet lidhur me çështjet.

Kryetarja – Shfaqti shqetësimin se gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit, ka hasur në mos zbatimin e tij. Në raste të theksuara nëpër komuna, bëri të ditur se në disa raste as që kanë ditur se ka ligj, e lëre më se është bërë plotësimi e ndryshimi i tij.

Ethem Çeku – Falënderoi Grupin e Punës që kreu këtë punë dhe premtoi se do të japë kontributin e tij në hartimin e draftit përfundimtar të Raportit, në mënyrë që rekomandimet të dalin sa më të arsyeshme. Propozoi që Raporti përfundimtar të dalë në emër të Komisionit, e jo në emër të Grupit të Punës. Po ashtu theksoi se mesazhi i Komisionit në Kuvend për ministrin është mesazh tepër i vrazhdë, d,m,th. kemi zhvillime, por nuk janë të bazuara në aspektin ligjor. Prandaj kërkoi të shikohet rekomandimi 2 (dytë) se ndërtimet po zhvillohen jashtë udhëzimeve administrative. Tjetër është nëse Ministria ka pasur apo nuk ka pasur kohë që t'i nxjerrë ato.

Kaqusha Jashari – Ishte e pajtimit të mos bëheshin shumë udhëzime administrative, sepse ato mund të ndërrohen shumë më lehtë, por kjo i mundëson secilës qeveri të ndryshojë atë që është punuar përpara.

Zef Morina – Sqaroi se është shënuar gabimisht rekomandimi 2 (dytë), sepse Ministria nuk nxjerr kritere teknike, por udhëzime administrative për shfrytëzimin e kritereve që janë vendore apo ndërkombëtare. Shtoi se udhëzim administrativ nuk ka, por nuk do të thotë se kriteret teknike nuk zbatohen. Dhe kërkoi të vazhdojë puna e Grupit të Punës më tutje.

Berim Ramosaj – Tha se ajo çka është e rëndësishme në konkluzionet e Raportit, nën 1 (një) shihet se duke marrë për bazë problemet e identifikuara, Grupi i Punës konkludon se Ligji për rrugët ka pengesa në zbatim dhe kërkoi të merren masa për ndryshimin e gjendjes, kurse materiali të identifikohet më mirë. Nën 2 (dy) te përcaktimi i kriterëve, përkatësisht në hartimin e listës prioritare, për ndërtimin e rrugëve të reja ose rikonstruimin e tyre, të autorizohet Grupi i Punës, se a janë në harmoni ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve që po bëhet në praktikë, me atë që e ka miratuar Qeveria? Ku do të pajisej Grupi i Punës, qoftë ndonjë material, qoftë ndonjë zyrtar i ministrisë mund t’i japë këto njoftime dhe të identifikohet a po zbatohen kriteret e ndërtimit dhe të ristrukturimit të rrugëve në harmoni me planin e Qeverisë. Ky është i vetmi shans që ka mbetur të bëhet kontrolli ndërmjet standardeve ose anës normative që e kanë paraparë si prioritet në fillim të punës Qeveria ose Ministria dhe realizimin në praktikë.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni, nxori këtë:

Përfundim

I. Grupi i punës të vazhdojë punën deri në hartimin përfundimtar të Raportit

III. Të ndryshme Çështje vijuese

Kryetarja – I njoftoi deputetët se ua ka dërguar nga një shkresë zyrtare ministrive të linjave përkatëse për Raportin e progresit. Mirëpo theksoi se ende nuk ka përgjigje nga asnjë ministri. Kërkoi nga kryesuesit e grupeve të punës ta intensifikojnë punën dhe t’i paraqesin raportet e tyre, gjegjësisht Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, Projektligjin për masat antidamping, Projektligjin për gazin natyror dhe Projektligjin për standardizim.

Ethem Çeku – Kërkoi nga Komisioni ta përkrahë propozimin e tij, që në një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit të shqyrtohet tërësisht çështja e Bordeve të Agjencive që i raportojnë Komisionit. Këtë çështje mund të ngrisim atëherë dhe të kërkojmë nga Qeveria një azhuret më të madh, sepse si Komision po përballemi shumë në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani